




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA GRAHOVAČ / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRJETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRÉSEDINA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Krjetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 919 Nr. i faq./Br.str./No pg 93  
Data/Datum/Date 26.10.2020  
RAHOVEC / GRAHOVAČ

**MASAT DHE VEPRIMET NGA KOMUNA E RAHOVECIT PËR PARANDALIMIN E VIRUSIT KORONA (SHTABI I POSAÇËM EMERGJENT NË KOMUNËN E RAHOVECIT)**



**INFORMATË PËR KONSULTIM PUBLIK ME GRUPE TË INTERESIT DHE PËRFAQËSUES TË OJQ-VE QË VEPROJNË NË KOMUNËN E RAHOVECIT**

**HYRJE- KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT ( SHEF I SHTABIT TË POSAÇËM EMERGJENT )**

*Të nderuar qytetarë,*

Në vazhdim, po ju informojmë lidhur me masat dhe veprimet nga Komuna e Rahovecit për parandalimin e infeksionit COVID -19, Virusit Korona.

Në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, Komuna e Rahovecit ka ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona (COVID-19).

Me këtë rast, duam të shprehim edhe njëherë mirënjohje dhe falenderim për mjekët, infermierët, policët, inspektoratin komunal, Kryqin e Kuq dhe gjithë akterët e tjerë institucional për punën dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm në kuadër të Shtabit të Posaçëm Emergjent Komunal, nënshtabet lokale, si dhe bizneset, në respektimin e masave në parandalimin dhe menaxhimin e kësaj beteje.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Rahovec ka situatën nën kontroll dhe është duke ofruar shërbimet shëndetësore për të gjithë pacientët e komunës sonë.

Po ju informojmë, se në komunën tonë aktualisht kemi 37 raste të paraqitura me COVID 19, prej tyre 31 janë shëruar plotësisht ndërsa dy për fat të keq kanë ndërruar jetë, të njëjtit kanë pasur edhe sëmundje tjera shoqëruese, pra aktualisht kemi gjithsej 4 raste aktive me COVID-19, e që shumë shpejt presim që edhe këta pacientë të shërohen, pasi që jemi duke shkuar drejt fundit së përballjes me COVID-19.

Numri i rasteve me COVID-19, në komunën e Rahovecit	Vendbanimi	Gjithsej të shëruar :	Raste aktive	Vdekje të konfirmuara
61 raste	54 raste në Rahovec 5 raste në Opterushë 1 rast në Retijë 1 rast në Kramovik ( me vendbanim në Prishtinë)	34	22	5

Si Kryetar i Komunës shpreh shqetësimin tim për mungesën e pajisjeve, materialeve dhe furnizimeve të tjera shtesë me barna esenciale për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. Vazhdimisht jemi ballafaquar me mungesë të materialit mbrojtës për personelin mjekësor si maskat mbrojtëse, dorezat, dezinfektues, rroba mbrojtëse dhe syza mbrojtëse për personelin shëndetësor që janë vija e parë e frontit me COVID-19. Kërkoj nga Qeveria, gjegjësisht nga Ministria e Shëndetësisë për furnizim me mjete të nevojshme për punëtorët shëndetësorë, të sigurisë dhe punëtorët e tjerë të institucioneve publike që ta tejkalojmë më lehtë sfidën e madhe që kemi. Qeveria ka për detyrë të na ndihmojë konkretisht me pajisje elementare për të ofruar më shumë siguri dhe kushte sa më të përshtatshme shëndetësore për qytetarët tanë.

*Pavarësisht kësaj, që nga shfaqja e rasteve të para në Kosovë me Virusin Korona, Komuna e Rahovecit ka hartuar dhe vënë në zbatim Planin e Gatishmërisë dhe të Reagimit për Coronavirus COVID-19, duke zbatuar masat si:*

- Me vendimin tim është formuar Shtabi i Posaçëm Emergjent i cili udhëhiqet nga unë si Kryetar Komune kurse në të bëjnë pjesë: Kryesuesi i KK, drejtorët komunal, drejtori i QKMF-së, Komandanti i Stacionit Policor në Rahovec si dhe Komandanti i Njësisë së Zjarrfikësve;
- Në frymën e përpjekjeve për të parandaluar infeksionin COVID-19, kemi vendosur që Shtabit të Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit ti bashkohen edhe: KRYETARËT DHE KËSHILLAT E FSHATRAVE DHE LAGJEVE URBANE NË QYTETIN E RAHOVECIT, shtabet e formuara në secilin fshat dhe lagje të qytetit të Rahovecit do të udhëhiqen nga kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane dhe janë në koordinim të plotë me Shtabin e Posaçëm Emergjent ;
- Stacioni Policor në Rahovec ka ofruar gatishmërinë që sipas kërkesave të Komunës të asistojë në zbatimin e masave parandaluese;
- Sipas vendimit të qeverisë, janë mbyllur të gjitha kafiteritë, baret dhe restaurantet, me përjashtim të farmacive dhe marketve ushqimore;
- Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë Nr/08 Pika nr.9, kam marrë vendim që të reduktohet stafi i zyrtarëve komunal në të gjithë sektorët përveç: personelit shëndetësor dhe Inspektoriatit komunal, si masë preventive ndaj infeksionit (COVID -19);
- Është bërë pezullimi i të gjitha tubimeve, manifestimeve apo evenimenteve publike deri në një njoftim të radhës;
- Sipas vendimit të Qeverisë, janë ndërprerë menjëherë linjat e autobusave nga Rahoveci në drejtim të komunave tjera;
- Janë mbyllur përkohësisht zyrat e gjendjeve civile në bashkësitë lokale të komunës së Rahovecit;
- Punëtorët e sporteve janë pajisur me dezinfektues si dhe gjatë kësaj kohe punojnë me staf të reduktuar dhe me ndërrime të caktuara nga Drejtoria për Administratë;
- Komuna e Rahovecit, përkatësisht DSHMS-ja, së fundmi ka planin operativ duke caktuar edhe vendin për ngritjen e një karantine e cila në rast nevojë, do të përdoret me qëllim të menaxhimit të rasteve të ekspozuara ndaj virusit, sipas nevojës;
- Kemi vendosur për reduktimin e takimeve me palë në të gjitha drejtoritë, përveç rasteve që konsiderohen të natyrës urgjente;
- Janë krijuar komisione për inspektimin e të gjitha bizneseve, qendrave tregtare, barnatoreve për mundësinë e manipulimit ( ngritjes) së çmimeve të produkteve;
- Në vijim të masave për të parandaluar përhapjen e COVID-19, për të shuar çdo mundësi përhapjeje të këtij virusi, janë mbyllur tregjet në këto vendbanime: Rahovec, Krushë e Madhe dhe Ratkoc;
- Pas rritjes së panikut jo real të qytetarëve mbi mungesën e produkteve të grurit (miellit), kam vizituar ndërmarrjet “M-Sillosi” në Xërxe, “Vetoni” në Rahovec dhe “Burimi” në Çifllak, për t’u informuar me gjendjen reale të kapaciteteve prodhuese në këto ndërmarrje, Komuna e Rahovecit falë këtyre ndërmarrjeve përpunuese të grurit është duke ofruar shërbimet e nevojshme, konkretisht furnizimin me miell edhe për komunat e tjera të Republikës së Kosovës;

- Inspektorati Komunal po vazhdon me vizitat në qendrat tregtare, biznese për të verifikuar nëse ka rritje artificiale të çmimeve. Deri më tani Inspektorati nuk ka hasur në raste të tilla por që inspektimet do të vazhdojnë edhe ditëve në vijim;
- Për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe shumë të lartë që secili prej nesh të infektohet me COVID-19, për të parandaluar frekuentimin e pakontrolluar, në vende rekreative të hapura si: Maja e Shkodranit, Ura e Fshajtë etj, Shtabi i Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit ka marrë këtë VENDIM: Ndalohen lëvizjet në grupe dhe grumbullimet e qytetarëve, në këto zona;
- Inspektorët komunal po i vazhdojnë inspektimet 24 orë në terren, dhe janë duke e kryer punën në mënyrë të organizuar, është bërë edhe lirimi i trotuareve nga mallrat, poashtu, furrat që shërbejnë në komunën e Rahovecit janë të obliguar që bukën ta mbështjellin me material mbrojtës;
- Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurt për qytetarët, tashmë kemi marrë vendim që në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, edhe ditën e shtunë të punohet me orar të rregullt;
- Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal, është miratuar propozim-vendimi im për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 10.000 euro, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19. Më anë të këtij vendimi kemi vënë në dispozicion 10.000 (dhjetëmijë) euro, mjete këto që do të shfrytëzohen për mbulimin e kërkesave dhe nevojave të Shtabit të Posaçëm Emergjent, më saktësisht për menaxhimin e situatës së krijuar nga ky virus, duke përfshirë këtu furnizimin me barna ose përkrahjen për rastet sociale;
- Pas situatës së krijuar së fundmi nga pandemia e shfaqur COVID-19, Kuvendi Komunal Rahovec, me qëllim të krijimit të lehtësirave për bizneset e komunës sonë ka marrë këtë VENDIM: Të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, e që gjithsej janë 31, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale, lirohen nga pagesa e qirasë mujore për periudhën: (mars-maj 2020); Lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën e Rahovecit, të cilët aktualisht janë të ngarkuar me rregulloren aktuale për taksa komunale, (mars-maj 2020);
- Pas përpjekjeve të shumta që kemi bërë si Komunë, adresimit serioz e me urgjencë të kërkesave, nevojave dhe shqetësimeve, të koordinimit me kryetarët e komunave përmes AKK-së, si dhe angazhimit të Ministrisë së Bujqësisë, karshi masave të reja për kufizimin e lëvizjes, masa këto të cilat pamundësonin qasjen e fermerëve tanë në tokat e tyre, kemi arritur që: FERMERËT KANË TË DREJTË TË LËVIZIN DHE PUNOJNË TOKAT E TYRE NGA ORA: 06:00- 20:00. Fermerët individual janë pajisur me Nr. Identifikues të Fermës (NIF), i cili është marrë pranë zyreve të Drejtorisë së Bujqësisë në Komunën e Rahovecit. Poashtu, fermerët janë obliguar që me vete të marrin masat mbrojtëse si: (maska, dorëza) dhe patjetër t'ju përmbahen rekomandimeve të IKSHPK-së.
- Situata e krijuar pas shfaqjes së pandemisë COVID-19, ka krijuar vështirësi të mëdha për plasimin e produkteve bujqësore në treg, andaj si Komunë kemi bërë përpjekje të vazhdueshme që të sigurojmë qasjen e nevojshme për shitjen e këtyre produkteve, pra sigurimin e hapësirës për treg, më lejoni të ju informoj se tregu në afërsi të Shtëpisë së Verës (Konakut), është i

gatshëm për hapje, por nuk kemi arritur të sigurojmë pritje lejën përkatëse për zhvillimin e tregut në Rahovec, edhe pse në qytete tjera të Kosovës, zhvillimi i tregut është lejuar dhe po fermerët tanë produktet e tyre i kanë shitur në qytete të ndryshme të Republikës së Kosovës.

- Edhe përkundër faktit se distanca prej 6 metra mes tezgave për shitje ndërmjet fermerëve, do të ishte e mjaftueshme për respektimin e rekomandimeve të IKSHPK-së dhe institucioneve tjera kompetente nuk na është lejuar hapja e tregut, sa për informatë, DBPZHR, ka përgatitur edhe një plan operativ, plan ky i cili do të shërbente për mbarëvajtjen e tregut gjithmonë duke u bazuar në respektimin e masave si dhe përdorimin e mjeteve mbrojtëse si maska dhe doreza nga ana e fermerëve të cilët do shesin prodhimet e tyre, anasjelltas e njëjta vlen edhe për ata qytetarë të cilët do të furnizoheshin me këto prodhime. Inspektorati Komunal bashkë me Stacionin Policor në Rahovec dhe Stafin e drejtorisë së bujqësisë, kanë qenë në gatishmëri të plotë për të monitoruar situatën dhe ecurinë e mirëfilltë të zhvillimit të tregut.
- Drejtorja e Bujqësisë nga java e kaluar, është duke i vizituar të gjithë fermerët të cilët prodhimet e tyre nuk kanë mundur ti shesin si shkak i pandemisë COVID-19. Në bazë të të dhënave të grumbulluara do të përpilojë një raport të detajuar, të cilin do ta dërgojmë në MBPZHR, ku do të kërkohet kompensimi i këtyre dëmeve të shkaktuara. Fermerët tani gjinden në një situatë të pa përballeshme për ta, prandaj përkrahja direkte në këtë kohë është mëse e nevojshme.

Pas situatës së krijuar nga rreziku i infeksionit COVID-19, ka shumë familje të cilat në këto ditë jo të lehta kanë nevoja të shumta dhe nuk kanë mundësi për të përmbushur kërkesat themelore për familjet e tyre, andaj më lejoni që në emër tim dhe qytetarëve të komunës së Rahovecit të falënderoj të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë, individë e biznese, të cilët po vazhdojnë, traditën, humanizmin dhe solidaritetin, në mbështetje të qytetarëve, duke dhuruar kështu donacione të ndryshme si pako ushqimore dhe higjienike, destilat, dezinfektues për duar, ndihmë në vlerë monetare etj. Shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike, është duke u bërë në përputhje me listat e përpiluara në bashkëpunim me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane në qytetin e Rahovecit, Qendrën për Punë Sociale në Rahovec dhe Kryqin e Kuq, me vendimin tim është formuar edhe komisioni për shpërndarjen e këtyre pakove, komision ky i cili ka për detyrë të kontribuojë për mbarëvajtjen e një procesi të rregullt, gjatë shpërndarjes.

Për të evituar pritjen në radhë, rrezikun e përhapjes së virusit, kemi kërkuar nga qytetarët që të qëndrojnë në shtëpitë e tyre pasi që shpërndarja e pakove ushqimore do të bëhet në secilin vendbanim.

Në vazhdim, gjeni të dhënat lidhur me të gjithë ata që në forma të ndryshme kanë kontribuar me donacione për familjet në nevojë të komunës së Rahovecit:

LISTA E DONACIONEVE TË DHURUARA PËR KOMUNËN E RAHOVECIT

Nr.	Donatori	Sasia e dhuruar/ Lloji
1	Viva Fresh Store	250 Pako ushqimore
2	"Elkos Group-Etc", "Devolli Group"	400 familje, me: 400 thasë miell, 800L qumësht dhe 800L lëngje
3	"BIO-PAK SH.P.K"	400 euro, me të cilat janë blerë 404 litra vaj
4	"Stone Castle Vineyards and Winery"	Dhurim donacioni Ministrisë së Shëndetësisë prej 10.000 litrave të alkoolit etilik (destilat), gjithashtu, ajo i ka dhuruar destilat edhe Komunës së Rahovecit dhe Stacionit Policor në Rahovec
5	Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"	100 thasë miell dhe 100 pako ushqimore bazike
6	"Bodrumi i Vjetër"- Rahovec	1000 copë (100ml) dhe 600 copë (500ml) dezinfektues për duar
7	Teqeja e Madhe e Halvetive, përkatësisht prijësi i saj Shejh Besim Shehu	100 pako ushqimore dhe 100 thasë miell
8	UNICEF	250 pako higjienike
9	KOMITETI NDËRKOMBËTAR I KRYQIT TË KUQ, MISIONI NË KOSOVË	30 pako higjienike
10	z. Edmond Hajda nga Rahoveci	100 pako ushqimore dhe 100 thasë miell
11	Bajrush (Alush) Krasniqi nga fshati Ratkoc	1000 € donacion
12	Teqeja e Madhe e Halvetive, përkatësisht prijësi i saj Shejh Besim Shehu	Një Tunel Dezinfektues i cili është vendosur në objektin e Komunës së Rahovecit
13	z. Esat Cenka, z.Nehat Cenka dhe z. Sedat Cenka nga Rahoveci	72 pako ushqimore dhe 72 thasë miell
14	"AEP", "INICIATIVA POZITIVE", "RAMA PRINT", "AUTO- ROMANEL SA" dhe "RAIL TRANS"	Kanë dhurua një Tunel Dezinfektues i cili është vendosur në rrugën kryesore të qytetit të Rahovecit( te semaforat).
15	Fondacioni " LABINOT TAHIRI"	100 pako ushqimore - higjienike
16	z.Afrim Kasapi nga Rahoveci	200 pako ushqimore dhe 200 thasë miell
17	z.Munib Rahmoni nga Rahoveci	100 pako ushqimore dhe 100 thasë miell
18	Kompania " Mendi- P", nga Kramoviku	40 pako ushqimore dhe 40 thasë miell
19	z.Jeton Merxha nga Rahoveci	100 thasë miell
20	"PETROL COMPANY"	10 pako ushqimore
21	Elhami Zeka nga Pataqani i Ulët	20 pako ushqimore dhe 50 thasë miell
22	z.Beshir Sokoli nga Rahoveci	50 pako të shpërndara për familjet në nevojë dhe 11 pako ushqimore të dorëzuara në QPS
23	z.Edmond Hajda nga Rahoveci	20 pako ushqimore
24	"KOSOVA MED- HEALTH CARE"	500 maska mbrojtëse, 300 dorëza mbrojtëse dhe 10 palë rroba mbrojtëse donacion për QKMF-në në Rahovec
Gjithsej pako për familje në nevojë:		1,392.00 pako ushqimore, 862 thasë miell 280 pako higjienike

Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si : objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e Administratës Komunale, objektet fetare: ( Xhamitë dhe Teqet), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive. Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo vikend, ndërsa reparti i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy herë në javë për shkak se janë reparte më të frekuentuara nga qytetarët tanë.

Tashmë, për pesëmbëdhjetë herë radhazi, kemi vazhduar me dezinfektimin e institucioneve shëndetësore dhe publike, poashtu për katër herë radhazi kemi dezinfektuar hapësirat publike në qytetin e Rahovecit si dhe rrugët dhe hapësirat publike në të gjitha fshatrat e komunës së Rahovecit.

#### LISTA E OBJEKTEVE TË DEZINFektUARA NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Objektet e dezinfektuara	Numri i objekteve	Dezinfektimi nga:
QKMF, QMF-të, AMF-të	14- objekte shëndetësore	Komuna Rahovec
Objekte fetare	24 -xhami në tërë Komunën e Rahovecit	Komuna Rahovec
Objekte fetare	2 -teqet në Rahovec	Komuna Rahovec
Objekte kulturore dhe sportive	Palestra Sportive, shtëpitë e kulturës	Komuna Rahovec
Stacioni i autobusëve	1-Stacioni i autobusëve në Rahovec	Komuna Rahovec
Stacionet Policore	2- Stacioni policor në Rahovec dhe nënstationi Policor në Zoqisht	Komuna Rahovec
Objektet e Komunës së Rahovecit	2- Objektet e Administratës Komunale në Rahovec, të dezinfektuara në tërësi	Komuna Rahovec
Institucione të drejtësisë	Objekti i Gjykatës Themelore Gjakovë- dega në Rahovec	Komuna Rahovec
Institucione arsimore	Çerdhja "Tulipanët" në Rahovec	Komuna Rahovec
Spektori privat	Kompanitë private që kanë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve	Komuna Rahovec

Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me kompanitë për mirëmbajtje dhe falë ndihmës së KRU –GJAKOVA, ndihmës së fermerëve tanë të cilët ju kanë përgjigjur thirrjes për t’ju dalur në ndihmë kompanive dhe vullnetarëve të angazhuar, në mënyrë që i gjithë procesi të kryhet sa më mirë që është e mundur, ka bërë pastrimin e rrugëve, lagjeve në të gjithë territorin e komunës së Rahovecit, poashtu është bërë edhe pastrimi i deponive ilegale.

Rrugë të dezinfektuara në tërë territorin e Komunës së Rahovecit/ km	Dezinfektimi nga:	Vendbanimet
Gjithsej rrugë të dezinfektura- 170km	Kompanitë "EKO- REGJIONI", "EKO-DRINIA", fermerë vullnetarë	Dezinfektimi është bërë në tërë territorin e komunës së Rahovecit
	Komuna Rahovec	

Vendimet
Vendim për themelimin e Shtabit të Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit dhe Kuvendit Komunal Rahovec, 14 mars 2020
Vendim për reduktim të stafit të zyrtarëve komunal , 16 mars 2020
Vendim për themelimin e nënshtabeve locale, 21 mars 2020
Vendim: Të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit, e që gjithsej janë 31, të cilët kanë kontratë për shfrytëzimin e objekteve komunale, lirohen nga pagesa e qirasë mujore për periudhën: (mars-maj 2020); Lirohen nga taksa komunale të gjitha bizneset që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën e Rahovecit, të cilët aktualisht janë të ngarkuar me rregulloren aktuale për taksa komunale, (mars-maj 2020);
Për shkak të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe shumë të lartë që secili prej nesh të infektohet me COVID-19, për të parandaluar frekuentimin e pakontrolluar, në vende rekreative të hapura si: Maja e Shkodranit, Ura e Fshajtë etj, Shtabi i Posaçëm Emergjent në Komunën e Rahovecit ka marrë këtë VENDIM: Ndalohen lëvizjet në grupe dhe grumbullimet e qytetarëve, në këto zona të lartëcekura.
Vendim mbi ndarjen e 10,000€, për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19
Vendim për masat e parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19, dhe reduktimin e stafit të zyrtarëve të Komunës së Rahovecit.

Me respekt!

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës së Rahovecit

